

Vendim nr.371, datë 6.5.2020 “Për dhënie shpërblimi për personelin që shërben në institucionet e përkujdesjes shoqërore rezidenciale publike,që janë në përgjegjësi administrimi të shërbimit social shtetëror dhe të bashkive“

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, u aprovua ky vendim i cili parashikon dhënien e një shpërblimi në masën 55 000 (pesëdhjetë e pesë mijë) lekë, për personelin që shërben në institucionet e përkujdesjes shoqërore rezidenciale publike,që janë në përgjegjësi administrimi të Shërbimit Social Shtetëror dhe të bashkive, të angazhuar në shërbimin ndaj përfituesve të sistemuar në këto institucionederi në përfundim të epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-19. Shpërblimin e përfiton personeli që shërben në institucionet e përcaktuara në pikën1, të këtij vendimi, dhe që është caktuar nga drejtuesi i institucionit për të punuar përtej kushteve normale të punës, me qëllim parandalimin e infektimit nga COVID-19 të përfituesve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore rezidenciale publike, sipas një grafiku të dakordësuar ndërmjet tyre.

Lexoni të plotë në: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/05/06/371/05b9edad-bdf8-4a3b-bb5f-fb9459508bba>